

VENDIM
Nr.646, datë 17.10.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 557, DATË 3.8.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË VARËSISË STRUKTURE, E
ORGANIKËS DHE TË NUMRIT LIMIT TË PUNONJËSVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “ Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Skema “Struktura dhe përbërja organike e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 557, datë 3.8. 2005 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me “Skema nr.2” që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha